

# RAPORT MONITORIMI

## Nr. 3

mbi kufizimet e  
përdorimit  
të burimeve  
shtetërore në  
fushatën  
zgjedhore

*Periudha*

1 -28 shkurt 2021

Raportues:

Isuf Shehu, Gerta Meta  
(Alumni të ASP)

Me bashkëpunimin e  
pedagogëve dhe stu-  
dentëve monitorues  
pranë universiteteve  
në shtatë rajone të  
vendit

*Projekti*

*"Forcimi i Transparencës  
së Zgjedhjeve në Shqipëri"*

Ky projekt mbështetet nga ambasada e Mbretërisë së Holandës në Tiranë dhe programi i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian "Aksioni kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri"



Kingdom of the Netherlands

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented  
by the Council of Europe

Ky raport pasqyron gjetjet e monitorimit një mujor të zbatimit të dispozitave të reja të Kodit Zgjedhor, në drejtim të:

- Praktikës ligjore dhe institucionale për zbatimin e kufizimeve mbi burimet shtetërore;
- Procesit të raportimit dhe kontrollit të veprimtarive të ndaluara të zyrtarëve qendrorë dhe vendorë;
- Aktet ligjore të miratuara në shkelje të ndalimeve të parashikuara në periudhën 4 mujore para zgjedhjeve.

## Praktika ligjore dhe institucionale për zbatimin e dispozitave

Procedimi administrativ ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, mbi 10 raste të denoncuar nga Lëvizja Socialiste për Integritim (LSI) për promovime të objekteve të rindërtuara nga tërmeti, ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme të kësaj periudhe monitorimi. Jo vetëm për shkak të peshës politike të zyrtarit të denoncuar, por edhe vendosjes në një provë reale të funksionimit të strukturës së re të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar mbi provat e paraqitura si dhe një hetim administrativ të kryer prej tij, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me [vendimin nr.46, datë 09.02.202](#), vendosi gjobitjen e kryetarit të bashkisë Tiranë, në shumën 35 000 lekë për mosraportim të aktiviteteve publike, si dhe në shumën 40 000 lekë për shpërndarje të certifikatave të pronësisë në periudhën parazgjedhore.

Pas ankesës së z.Veliaj, çështja u morr në shqyrtim nga Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), i cili me [vendimin nr. 6, datë 16.02.2021](#), vendosi me një votim 3 me 2 të anëtarëve të tij që të shfuqizojë të dyja masat administrative të Komisionerit. U deshën mbi shtatë ditë që të dorëzohej ky vendim zyrtar pranë KQZ (u publikua vetëm më 24 shkurt) dhe u konstatua se ashtu si edhe në rastin e mëparshëm të procedimit ndaj drejtorit të Kadastrës së Lushnjës, anëtarët e komisionit kanë dalë me argumentime krejt kundërta për të njëjtat kufizime të parashkuara nga Kodi Zgjedhor si dhe rregullorja e miratuar nga KQZ. Për më tej, kësaj here, pati edhe një qëndrim të tretë mbi vendimin nga anëtari i KAS, z. Ilir Rusmajli, si një dëshmi e mëte-

jshme e debateve dhe ndarjeve që ekzistonin mbi vendimmarrjen përkatëse brenda komisionit të përbërë nga vetëm pesë anëtarë. Ky vendim i KAS u ankimua në vijim nga LSI në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila më 4 mars, shpalli moskopeshtëci dhe kalimin e ankesës pranë Gjykatës Administrative Tiranë.

Vlen përt'u theksuar se që prej këtij vendimi për rrëzimin e ndëshkimit ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë, nuk ka patur asnjë denoncim të mëtejshëm mbi veprimtari të ndaluara të zyrtarëve në portalin përkatës të KQZ nga subjekte politike, organizata apo qytetarë.

Për më tej, interpretimet krejtësisht të kundërta ligjore dhe qëndrimet bipartizane të anëtarëve të KAS, risjellin në kujtesë praktikën e konsideruar si të tejkaluar të vendimmarrjes politike të KQZ së mëparshme. Mesa duket, shtresëzimi i ri i KQZ me tre struktura paralele (Administrative – Rregullatore - Ankimore), nuk mund të jetë zgjidhja e vetme për një KQZ funksionale. Ky konstatim është sigurisht një ogur i keq jo vetëm për kufizimet e Kodit Zgjedhor mbi veprimtaritë shtetërore, por edhe për vendimmarrje të tjera edhe më të rëndësishme që priten nga KQZ në javët në vijim mbi procesin zgjedhor dhe administrimin e tij.

## Raportimi i veprimtarive publike

Zyrtarët e lartë publikë qendrorë dhe vendorë ngarkohen nga [Kodi Zgjedhor](#) me detyrimin që të raportojnë paraprakisht pranë KQZ veprimtaritë e tyre publike në periudhën 4-mujore para zgjedhjeve. Deri më 28 shkurt, në ndërfaqen (<https://aktivitete.kqz.gov.al/>) rezultojnë se janë regjistruar 311 institucione publike, nga të cilat janë raportuar gjithsej 673 aktivi-

tete. Që nga hyrja në fuqi e kufizimeve, figurojnë të jenë kryer 42 denoncime nga subjekte politike dhe organizata të ndryshme, të cilat po shqyrtohen më tej nga strukturat përkatëse të KQZ. **Në fund të muajit shkurt, KQZ finalizoi procedurën për rekrutimin e monitoruesve të saj të financimit të fushatave si dhe përdorimit të burimeve shtetërore. Këta monitorues janë duke u trajnuar nga partnerët ndërkombëtarë dhe në ditët në vijim do të mund të nisnin monitorimin në terren të veprimtarive të ndaluara në fushatën zgjedhore në çdo rajon të vendit.**




Për të analizuar ecurinë e procesit të raportimit, u zhvillua një monitorim i aktiviteteve të publikuara nga antarët e kabinetit qeveritar dhe kryetarëve të bashkive në shtatë qytete kryesore të vendit. Këto veprimtari në faqet zyrtare online të institucioneve si dhe profilet e këtyre zyrtarëve në rrjete sociale (krye-

sisht Facebook), u kryqëzuan më pas me të dhënat e raportimeve të këtyre institucioneve në ndërfaqen e KQZ, për të sjellë një analizë të ecurisë së procesit të raportimit dhe disa rekomandime të mëtejshme. Të dhënat e monitorimit janë filtruar më tej për të eliminuar veprimtaritë e zyrtarëve që kanë patur lidhje me situatë emergjente (përmbytjet nga rreshjet).




Edhe gjatë kësaj periudhe të monitorimit mund të vihet re se kryeministri z.Edi Rama vazhdon të jetë jetë zyrtari më korrekt në procesin e raportimit të aktiviteteve të tij, por ndërkohë, konstatohet se mbi 90 përqind e vizitave dhe postimeve të tij gjatë këtyre dy muajve (mesatarisht 4 aktivitete në ditë) kanë në fokus promovimet fizike apo edhe në imazhe të veprave infrastrukturore, rindërtimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti apo edhe prezantimit të investimeve të ardhshme strategjike. Këto veprimtari, që mund të përkthehen në përfitime



**Tabela përmbledhëse e aktiviteteve të zyrtarëve të lartë qendrore dhe vendor në periudhën 1-28 shkurt 2021**

Zyrtarë subjekt i raportimit	Raportime në KQZ*	Aktivitete promovuese**	Promovime të paraportuara
Kryeministri	119	119	0
Ministri i Mbrojtjes	5	0	0
Ministri i Brendshëm	2	0	0
Ministri i Drejtësisë	3	0	0
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	29	0	0
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	15	0	0
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	13	8	0
Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme	0	0	0
 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	0	14	14
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	4	6	2
Ministri i Kulturës	19	7	3
Ministri i Mjedisit dhe Turizmit	4	3	2
Ministri i Shtetit për Diasporën	0	0	0
Ministri i Shtetit për Rindërtimin	8	17	15
 Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin	0	7	7
 Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	0	1	1

**KRYETARËT E BASHKIVE**

Tiranë	46	30	8
Durrës	5	4	1
Shkodër	33	3	0
 Elbasan	0	10	10
Vlorë	1	13	12
 Korçë	0	6	6
 Gjirokastër	0	3	3

\*Të dhëna zyrtare nga ndërfaqja e raportimeve e KQZ për periudhën nën monitorim.

\*\*Vizita apo postime promovuese të investimeve në infrastrukturë dhe objekte publike që mund të përbëjnë shkelje në mungesë të raportimit

elektorale për subjektin politik në pushtet dhe një pozicionim i pabarabartë mes kandidatëve në fushatën zgjedhore, ishin qëllimi për të cilin u ndërmorrën kufizimet e reja të Kodit Zgjedhor. Duke nisur që nga 9 marsi, z.Rama dhe të gjithë ministrat e kabinetit (përveç ministrave të Kulturës) janë regjistruar zyrtarisht si kandidatë të subjektit politik Partia Socialiste dhe garojnë përballë kandidatëve të subjekteve të tjera politike apo kandidatëve të pavarur.

Listën e plotë të veprimtarive të zyrtarëve të monitoruar që nga hyrja në fuqi e kufizimeve të Kodit Zgjedhor mund t'i gjeni në databazën e projektit tonë:

[monitorimi.asp.al](http://monitorimi.asp.al)



### Monitorimi i akteve normative

Në funksion të Nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor, janë monitoruar Aktet Normative dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave, të cilët janë botuar në Fletoren Zyrtare për periudhën 01 – 28 shkurt 2021.

Rezultojnë si vendime në shkelje të Kodit Zgjedhor:

- 5 Akte ligjore
- 2 Vendime të Këshillit të Ministrave
- 1 Vendim Këshilli Bashkiak

të cilat sjellin përfitime apo masa lehtësuese për periudhën katër mujore para zgjedhjeve. Më konkretisht aktet e miratuara mund të konsultohen në [Aneksin 1](#).

Listën e plotë të akteve të miratuara që nga hyrja në fuqi e kufizimeve të Kodit Zgjedhor mund t'i gjeni në databazën e projektit tonë: [monitorimi.asp.al](http://monitorimi.asp.al)



### Rekomandime

Eksperienca e këtyre dy muajve të parë të funksionimit të kufizimeve të Kodit Zgjedhor si dhe vendimmarrja e Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), ka bërë të domosdoshme qartësimin e mëtejshëm të kufizimeve të veprimtarive publike të ndaluara të zyrtarëve nga Kodi Zgjedhor. Për më tej, rrethanat dhe sjellja e palëve subjekt i kufizimeve të parashikuara kanë dëshmuar tashmë nevojën që të ketë përmirësime të mëtejshme në kuadrin rregullator të parashikuar.

Me këtë synim, më 3 mars, Akademia e Studimeve Politike, në bashkëpunim me Shoqatën për Kulturë Demokratike dhe Institutin e Studimeve Politike, [dorëzuan zyrtarisht](#) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një kërkesë për ndryshimin e rregullores ([Vendimit nr.9/2020](#)) për raportimin e veprimtarive të ndaluara të zyrtarëve të lartë publikë gjatë periudhës parazgjedhore.

Më konkretisht tre propozimet e paraqitura janë:

- Ndryshimi i pikës 1.1 e nenit 3 të Vendimit 9/2020 duke hequr togfjalëshin “*për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar*”
- Përfshirjen e mediave sociale në përkufizimin “media publike” duke evituar çdo lloj mangësie dhe inkoherece në identifikimin dhe përcaktimin se çfarë përbën “veprimtari publike”.
- Qartësimin e përgjegjësisë administrative të zyrtarëve subjekt i kufizimeve të veprimtarive të ndaluara.

### Hartoi raportin:

Isuf Shehu - Gerta Meta

## ANEKS 1 – Aktet normative në shkelje të Kodit Zgjedhor

- Ligj nr. 167/2020** Për faljen e detyrimeve të Sigurimeve Shoqërore, që ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj institutit të sigurimeve shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfituar sipas ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose të vetëpunësuar.  
- Dekretuar nga Presidenti i Republikës; **Nr.Dekretit 11902**, Tiranë më 05.01.2021 - Fletore Zyrtare Nr. 3, datë 08.01.2021;

Ky ligj parashikon faljen e detyrimeve të papaguara të ish-punonjësve të nëntokës ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për disa përfitime të pëfituara sipas ligjit 8685/2000. Ky ligj përbën në vetvete një aministi, falje gjobash dhe detyrimesh të vendosura ndaj ish-punonjësve të nëntokës nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

- Ligj nr. 169/2020** “Për Njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”. - Dekretuar nga Presidenti i Republikës; **Nr.Dekretit 11903**, Tiranë më 05.01.2021 - Fletore Zyrtare Nr. 3, datë 08.01.2021;

Ky ligj parashikon njohjen si periudha sigurimi **për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore** kohën e punësimit në ish-kooperativat bujqësore për ato ish-kooperativa bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë.

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1173, datë 24.12.2020** “Për transferimin në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike të pronave të paluajtshme shtetërore me nr. 277, 344/1 dhe 345/1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 41,463 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale 2371, në fshatin Lajthizë, Bashkia Fushë-Arrës, në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrës, si dhe vënien e tyre në dispozicion për zhvillimin dhe ealizimin e Projektit Investues Strategjik “Kompleksi Turizëm Rural Lajthiza” - Fletore Zyrtare Nr. 16, datë 02.02.2021;

Këshilli i Ministrave nëpërmjet kësaj VKM-je, ka promovuar, mbështetur dhe ligjëruar një investim strategjik duke i vënë në dispozicion një investitori strategjik një sipërfaqe prej 41,463 m<sup>2</sup>, pasuri e paluajtshme pronë shtetërore për 30 vjet me tarifën 1 Euro, për zhvillimin dhe realizimin e projektit të investimit strategjik “Kompleksi Turizëm Rural Lajthiza” me subjekt investues “Lajthiza Invest”. Kjo pasuri shtetërore në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrës transferohet në dispozicion të “Investitorit Strategjik”, në bazë të ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

- 4. Ligji Nr.6/2021 datë 28.01.2021** Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.36, datë 23.12.2020, “Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së çertifikatës së kontrollit teknik”, shpallur me dekretin Nr. 11959, datë 10.2.2021 - Fletore Zyrtare Nr.24, datë 16.02.2021;

Nëpërmjet këtij ligji është miratuar akti normativ nr.36, datë 23.12.2020, me fuqinë e ligjit. Ky Akt Normativ i Këshillit të Ministrave ka zgjatur afatin e vlefshmërisë së Certifikatës së Kontrollit Teknik të mjeteve me motor (Kolaudimi i Makinave) për një periudhë prej 3 muajsh. Ky vendim përbën në vetvete një aministi apo falje detyrimesh dhe përfitim për atë kategori të caktuar individësh apo shoqëri të cilët kanë në përdorim një automjet dhe ligjërohen të qarkullojnë lirshëm pa një akt kolaudimi makine.

- 5. Ligji nr. 151/2020 datë 17.12.2020** Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar - Fletore Zyrtare Nr.27, datë 19.02.2021;

Në këtë ligj kemi ndryshimin e përqindjes së normës së rentës minerare me përmbajtjen e mineralit metalor, nga 1/3 në 0% për vitin 2021-2023.

- 6. Ligj nr. 168/2020 datë 23.12.2020** Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar. - Fletore Zyrtare Nr.27, datë 19.02.2021;

Në këtë ligj kemi uljen e përqindjes së tarifës doganore për “mjetet ujore për kënaqësi dhe sporte, të fryra me ajër ose gaz”, nga 15% në 2%. Ulja e kësaj tarife hyn në fuqi në datën 07.03.2021.

- 7. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 17.02.2021** “Për përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit / Partneritet Publik Privat, për Portin e Triport, Vlorë .- Fletore Zyrtare Nr.27, datë 19.02.2021;

Këshilli i Ministrave nëpërmjet këtij vendimi ka përcaktuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit / Partneritet Publik Privat, për Portin e Triport, Vlorë, duke promovuar dhe dhe iniciuar kështu një procedurë koncesioni (PPP).



Vendimi i mësipërm mund të përfshihet në rastet e “veprimtarive të ndaluara”, të parashikuara nga Vendimit nr. 9, datë 23.12.2020 (neni 3, pika 4) të Komisionit Rregullator të KQZ, mbi ndalimin e kontratave koncesionare dhe PPP.

8. Vendim i Këshillit Bashkiak Durrës nr. 7, datë 28.01.2021; *“Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr.599, datë 11.03.2019 “Për miratimin e përdorimit të fondit vjetor prej 8,800,000 lekë për Prokurimin e sipërmarrjes private të shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit”.*

Me propozim të Kryetares së Bashkisë Durrës Këshilli Bashkiak Durrës nëpërmjet këtij vendimi ka vendosur mbylljen e sektorit funeral së bashku me shërbimet e mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës, dhe kalimin me Operator Ekonomik, duke akorduar një fond prej (8,800,000 lekë dhe 37,600,000 lekë) për prokurimin e Sipërmarrjes Private, pra privatizimin.



Vendimi i mësipërm mund të përfshihet në rastet e “veprimtarive të ndaluara”, të parashikuara nga Vendimit nr. 9, datë 23.12.2020 (neni 3, pika 4) të Komisionit Rregullator të KQZ, mbi ndalimin e kontratave koncensionare dhe PPP.